

Na ndihmoni për t'i njohur më mirë pacientët tanë

Pyetjet për mbledhjen e informacionit rreth racës dhe përkatësisë etnike të pacientëve



Pse bëhen këto pyetje?

Ne po mbledhim informacionin në lidhje me racën dhe përkatësinë etnike nga të gjithë pacientët tanë me qëllim që t'i njohim ata më mirë. Ne mund të plotësojmë më mirë nevojat e komuniteteve të cilëve u shërbejmë në rast se dimë më shumë rreth kulturës dhe gjuhës së tyre. Ky informacion do të përdoret vetën për t'u siguruar të gjithë pacientëve të gjitha shërbimet e duhura të cilësisë më të lartë.

Pse më bëhen këto pyetje?

Ne mbledhim këtë informacion nga të gjithë pacientët. Kjo do të na ndihmojë për të parë ndryshimet shëndetësore midis popullsisë të ndryshme. Ne mund t'i pakësojmë këto ndryshime duke u siguruar të gjithë pacientëve shërbime të cilësisë së njëjtë.

A bëhen këto pyetje nga spitalet e tjera?

Sipas rregullave të reja shtetërore, të gjithë spitalet e Masaçusetsit duhet të mbledhin këtë lloj informacioni. Ne e mbledhim këtë informacion si pjesë të një përpjekjeje gjithë shtetërore për të përmirësuar shëndetin e të gjithëve.



Çfarë lidhjeje ka përkatësia etnike me shëndetin tim?

Studimet kanë treguar se ekzistojnë ndryshime në shëndetin e grupeve të ndryshme racore dhe etnike. Ne nuk e dimë se çfarë i shkakton këto ndryshime dhe duhet të mësojmë më shumë rreth tyre. Ne mund të punojmë për të eliminuar këto ndryshime duke siguruar të njëjtin kujdes cilësor për të gjithë njerëzit.



Si do të përdoret ky informacion?

Ne do ta përdorim informacionin për racën dhe identitetin që do të mbledhim nga të gjithë pacientët tanë për të parë nëse ekzistojnë ndryshime shëndetësore midis grupeve të ndryshme të popullsisë. Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë të njëjtin kujdes shëndetësor cilësor për të gjithë njerëzit. Ne gjithashtu do ta përdorim informacionin për të siguruar kujdesin shëndetësor në përputhje me kërkesat kulturore.

Qëllimi ynë është të plotësojmë nevojat e të gjithë pacientëve të cilëve u shërbejmë. Ne mund ta arrijmë këtë qëllim duke siguruar shërbimet e përkthimit, vënien në dispozicion të informacionit për pacientët në gjuhë të ndryshme, si dhe duke siguruar kujdesin shëndetësor nga ana e stafit tonë në përputhje me kërkesat kulturore.

Çfarë ndodh nëse unë nuk dëshiroj të jap këtë informacion?

Është në dëshirën tuaj nëse doni ta jepni këtë informacion. Ky informacion merret vetëm për të na ndihmuar të njohim mirë pacientët të cilëve u shërbejmë dhe kjo nuk do të ndikojë në kujdesin apo shërbimet që merrni.



Përmirësojmë shëndetin
e TË GJITHËVE



